



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 820/17 Prot.

Pogradec, më 19.02 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin shoqërues, për: "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec".

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2026

PROJEKT - VENDIM
NR. ____, DATË ____ . ____ .2026
PËR

"MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË POGRADEC"

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2 e ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative - territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ndryshuar, Ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, Ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", të ndryshuar, Ligjit nr. 24/2017, "Për administrimin e ujërave dhe të kullimit", Ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", të ndryshuar, Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" të ndryshuar, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, Ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" të ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar, VKM nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, relacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**



1. Miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Pogradec, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Zyrat në Bashkinë Pogradec nuk ofrojnë shërbim nëse dokumentacioni i kërkesës nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili konfirmon pagesën e taksave dhe tarifave vendore.
3. Pajisja me vërtetim për likuidim të taksave dhe tarifave vendore do të bëhet vetëm pasi kërkuesi të ketë likuiduar të gjitha detyrimet që ka ndaj Bashkisë Pogradec, pavarësisht objektit të kërkesës për vërtetim.
4. Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë pranë Bashkisë Pogradec, Njësitë Administrative si dhe Institucionet e Varësisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

**KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr. 850/Prot.

Pogradec, më 19. 02. 2026

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN PËR "MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE
VENDORE NË BASHKINË POGRADEÇ"

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) *Akte administrative me karakter normativ*
- 2) *Akte administrative me karakter individual*
- 3) *Akte administrative me karakter kolektiv*

Sipas përcaktimit të nenit 13, pika 2, të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, "Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Po kështu, ligji 197/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: "Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shirijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.

Më tej, ky ligj në nenin 8, shkronja "a", përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër, organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak, do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë, për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji u ka njohur ushtrimin e pushtetit.



Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i procedurës administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon:
"Akt normativ nënligjor" është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij.

Neni 3, pika 1, shkronja "a", e ligjit 44/2015 "Kodi i procedurës administrative", jep këtë përkufizim për **"Aktin administrativ"**:

a) **"Akti administrativ individual"** është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) **"Akti administrativ kolektiv"** është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij projekt vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të ligjit 44/2015 "Kodi i procedurës administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili nuk është shteruar në zbatimin e tij dhe që me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Pogradec dhe kundrejt një numri të pacaktuar subjektsh.

Gjatë zbatimit të tij ky projekt-vendim shtrin efektet në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec dhe në të gjithë qytetarët dhe bizneset të cilët paguajnë taksa dhe tarifa vendore.

Përfundimish konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik:

Jurist i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore: Esmeralda Topçiu

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

SISTEMI I TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË POGRADEÇ



Përmbajtja:

I. TAKSAT VENDORE

I.1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

I.1.1 Taksa mbi ndërtesat

I.1.2 Taksa mbi tokën bujqësore

I.1.3 Taksa mbi truallin

I.2 Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

I.3 Taksa e tabelës

I.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë

II. TARIFA VENDORE

II.1 Tarifa e pastrimit

II.1.1 Tarifa e pastrimit për Familjet

II.1.2 Tarifa e pastrimit për Bizneset

II.1.2.A Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 0-2 milion lekë

II.1.2.B Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 2-5 milion lekë

II.1.2.C Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 5-8 milion lekë

II.1.2.D Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 8-14 milion lekë

II.1.2.E Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro 14 milion- 50 milion lekë

II.1.2.F Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro mbi 50 milion lekë

II.1.2.E Tarifë pastrimi për subjekte transporti të cilët transportojnë për palë të treta, për çdo deklarim xhiro

II.1.2.G Tarifë pastrimi për transportin

II.1.2.H Tarifë pastrimi për çdo dhomë hoteli, motel, kompleksi turistik

II.1.2.I Tarifë pastrimi të tjera

II.2 Tarifa e gjelbërimit

II.3 Tarifa e ndriçimit

II.4 Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike

II.5 Tarifë për shfrytëzim të automjetit tip "Kosh"

II.6 Tarifa e shfrytëzimit të sipërfaqeve publike

II.7 Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore

II.8 Tarifa e pagesave për Liçensa, Çertifikata për Transport Rrugor

II.9 Tarifa e parkimi për mjetet e liçensuara dhe tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë

II.9.1 Tarifë për parkimin për çdo mjet të liçensuar

II.9.2 Tarifa e parkimit për mjetet që çertifikohen për transport udhëtarësh për llogari të vet, të cilët nuk kanë stacion qëndrimi me pagesë

II.9.2 Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë / transport udhëtarësh

II.9.3 Tarifë parkimi në vendparkime publike me pagesë

II.9.4 Tarifë parkimi tek terminali i autobuzave



- II.9.5 Tarifa për librat e udhëtimit për shërbime turistike / të rastit të udhëtarëve brenda vendit*
- II.10 Tarifat për shërbimet në bashkinë Pogradec*
- II.11 Tarifat për dhënie leje për ushtrim aktiviteti*
 - II.11.1 Tarifat për dhënie e Liçensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*
- II.12 Tarifat për Lejë për veprimtari të përkohshme*
- II.13 Tarifat për ndikimin në mjedis*
- II.14 Menaxhimi i shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës ujëtare nga OPU-të*
 - II.14.1 Tarifa e shërbimit të ujitjes*
 - II.14.2 Tarifa vjetore e mirëmbajtjes*
- II.15 Tarifa për hyrjen në muze*
- II.16 Tarifa për kuotat ushqimore në kopshte e çerdhe*
- II.17 Tarifat për shpenzimet e varrimit*
- II.18 Tarifa aplikimi për kalim pronësie të ndërtesave të ndërtuara para datës 10.8.1991*
- III.1 Tarifë për planet e detajuara vendore:*
- III.2 Tarifa aplikimi:*
 - III.2.1 Tarifa e aplikimit për Lejë ndërtimi*
 - III.2.2 Tarifa e aplikimit për rishikimin e kushteve të lejës (Ndryshime në Projekt gjatë Ndërtimit)*
 - III.2.3 Tarifa e aplikimit për shtyrje afati Lejë ndërtimi*
 - III.2.4 Tarifa e aplikimit për për rindërtim, restaurim, rikonstruksion:*
 - III.2.5 Tarifë aplikimi për ndryshim të subjektit ndërtues/zhvillues dhe për ndryshim të aktiviteteve dhe funksionit të njësive individuale:*
 - III.2.6 Tarifa e aplikimit për lejë prishje:*
 - III.2.7 Tarifë aplikimi për lejë zhvillimi:*
 - III.2.8 Tarifa e aplikimit për kryerje punimesh me deklaratë paraprake:*
 - III.2.9 Tarifa e aplikimit:*
 - III.2.10 Tarifa e aplikimit për "Njoftim fillim punimesh dhe monitorimi i procesit të zbatimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të tyre":*
 - III.2.11 Tarifa për verifikimin e akteve të kontrollit për përfundimin e*
 - III.2.12 Tarifa e aplikimit për "Raportin Final të Mbikqyrje Kolaudimin":*
 - III.2.13 Tarifa e aplikimit për Çertifikatë Përdorimi:*
 - III.2.15 Tarifa shërbimi në Arkivin teknik:*

KAPITULLI I

TAKSAT VENDORE



1. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME:

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në Ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

"Pasuri e paluajtshme" janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

"Kadastra Fiskale" është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

1. Taksa mbi ndërtesat.
2. Taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa mbi truallin.

1.1 Taksa mbi ndërtesat:

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë Ligj përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas Ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".

3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruar si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Cmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banim për Bashkinë Pogradec, sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018, "Për metodologjinë dhe përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit, të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve e rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, është 49,900 lekë/m².

Baza e taksës:

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat:

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2 % për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30 % e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Njësia Administrative/ Zona fiskale	Shkalla e taksës mbi ndërtesat/njësi pronësore që përdoret shfrytëzohet për:					
	Banim			Veprimtari ekonomike		
	Shkalla e taksës sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018	Ndryshimi i shkallës së taksës i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar	Shkalla e taksës sipas VKM nr. 132, datë 07.03.2018	Ndryshimi i shkallës së taksës i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar

Pogradec, fshati Tushemisht dhe fshati Buçimas	0.05 %	+30%	0.065 %	0.2 %	+30 %	0.26 %
Zona e qytetit dhe fshati Tushemisht (për ndërtesat para vitit 1993)	0.05 %	+30 %	0.065 %	0.2 %	+30 %	0.26 %
Buçimas(pëveç fshatit Tushemisht dhe Buçimas)	0.05 %	-5 %	0.038 %	0.2 %	-10 %	0.18 %
Udënisht	0.05 %	-5 %	0.038 %	0.2	-10 %	0.18 %
Çerravë	0.05 %	-5 %	0.038 %	0.2	-10 %	0.18 %
Dardhas	0.05 %	-5 %	0.038 %	0.2	-10 %	0.18 %
Proptisht	0.05 %	-5 %	0.038 %	0.2	-10 %	0.18 %
Velçan	0.05 %	-5 %	0.038 %	0.2	-10 %	0.18 %
Trehinjë	0.05 %	-5 %	0.038 %	0.2	-10 %	0.18 %

Njësitë Administrative përbërës	Çmimi referues i miratuar për banim Para vitit 1993	Shkalla e taksës e miratuar	Vlera për metër katror për banesat që përdoren/shfrytëzohen për banim
Pogradec, Fshati Tushemisht dhe Buçimas	49,900 lekë	0.065 %	32.43 lekë/m ²
Buçimas (pëveç fshatit Tushemisht dhe Buçimas)	32,435 lekë	0.038 %	12.33 lekë/m ²
Udënisht	32,435 lekë	0.038 %	12.33 lekë/m ²
Çerravë	32,435 lekë	0.038 %	12.33 lekë/m ²
Dardhas	32,435 lekë	0.038 %	12.33 lekë/m ²
Proptisht	32,435 lekë	0.038 %	12.33 lekë/m ²
Velçan	32,435 lekë	0.038 %	12.33 lekë/m ²
Trehinjë	32,435 lekë	0.038 %	12.33 lekë/m ²

Njësitë Administrative përbërëse	Çmimi referues i miratuar për banim Para vitit 1993	Shkalla e taksës e miratuar	Vlera për metër katror për banesat që përdoren/shfrytëzohen për banim
Pogradec, Fshati Tushemisht dhe Buçimas	34,930 lekë	0.065 %	21 lekë/m ²
Buçimas (pëveç fshatit Tushemisht dhe Buçimas)	22,705 lekë	0.038 %	8.6 lekë/m ²
Udënisht	22,705 lekë	0.038 %	8.6 lekë/m ²
Çerravë	22,705 lekë	0.038 %	8.6 lekë/m ²
Dardhas	22,705 lekë	0.038 %	8.6 lekë/m ²
Proptisht	22,705 lekë	0.038 %	8.6 lekë/m ²
Velçan	22,705 lekë	0.038 %	8.6 lekë/m ²
Trehinjë	22,705 lekë	0.038 %	8.6 lekë/m ²

së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.



Niveli i taksës mbi tokën bujqësore caktohet në Lekë për Hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore, përcaktohet sipas Aneksit 1, bashkëlidhur Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Kategoria 3, si më poshtë:

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Lekë/ha/vit sipas Ligjit
I	2 800
II	2 100
III	1 400
IV	1 350
V	1 150
VI	1 100
VII – X	1 000

Përjashtime:

Përjashtohen nga taksa, tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë pranë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a, në cilësinë e agjentit tatimor.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me Ujësjellësin faturohen direkt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë Bankave të Nivelit të II dhe Postës Shqiptare sh.a, ndarë në dy këste:

- Kësti i parë deri në 30 qershor të vitit fiskal
- Kësti i dytë deri në 31 tetor të vitit fiskal

Taksa mbi truallin:

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.



Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Njësitë Administrative	Vlera e taksës lekë/m ² /vit. për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës lekë/m ² /vit. për qëllime biznesi
Pogradec	0.28	15
Buçimas	0.20	12
Udënisht	0.20	12
Çerravë	0.20	12
Dardhas	0.20	12
Proptisht	0.20	12
Velçan	0.20	12
Trebinjë	0.20	12

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Detyrimi për familjarët shlyhet si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a, në cilësinë e agjentit tatimor. Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me Ujësjellësin, faturohen direkt nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me bazë vjetore.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë Bankave të Nivelit të II, ose Postën Shqiptare sh.a, ndarë në dy këste:

- Kësti i parë deri në 30 qershor të vitit fiskal
- Kësti i dytë deri në 31 tetor të vitit fiskal

Taksa e fjetjes në hotel:

Me "Hotel" kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Niveli i taksës së fjetjes në hotel Hotel me 4-5 yje Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të Ligjit për turizmin.

Tabela e taksës së fjetjes në hotel për Bashkinë Pogradec, sipas Aneksit 8 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar:



Kategoritë e Hoteleve	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotele me 4 ose 5 yje	lekë/natë qëndrimi	175
Hotele deri në 3 yje, bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të Ligjit për Turizmin	lekë/natë qëndrimi	70

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Vjelja e taksës së fjetjes në hotel bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet Ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre.

Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Kategoritë e ndërtesave, sipas Aneksit 3 të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar:

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Shkalla e taksës për njësi
Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	300
Ndërtesa për tregti dhe shërbime, përfshirë dhe zyra	Lekë/m ²	700
Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	500



Vjelja e kësaj takse bëhet nga Drejtoria Vendore Pogradec e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila në rolin e agjentit, përfiton 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit të bashkisë Pogradec, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të Ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.
- c) subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera, sipas ligjeve në fuqi.

TAKSA E TABELËS

Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Tabelat kategorizohen:

- a. Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarinë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.
- b. Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
- c. Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.



ç. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Lloji i tabelës	Njësia	Bashkia Pogradec
Takse tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve (ku shenohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit).		
Deri në 2 m ²	lekë/m ² /vit	0
Mbi 2 m ² deri 10 m ²		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	10 000
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	15 000
- Elektronike	lekë/m ² /vit	20 000
Mbi 10 m ² deri 20 m ²		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	8 500
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	12 750
- Elektronike	lekë/m ² /vit	17 000
Mbi 20 m ² deri 40 m ²		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	5 500
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	8 250
- Elektronike	lekë/m ² /vit	11 000
Mbi 40 m ²		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	4 000
- Me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	6 000
- Elektronike	lekë/m ² /vit	8 000
Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën e përmasat e tabelave për orientim.		
	lekë/m ² /vit	120
Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme dhe e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m ²		
- E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	22 500
- Elektronike	lekë/m ² /vit	45 000
Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
- Të të gjitha përmasave	lekë/m ² /ditë	1 000

Vjelja e taksës së tabelës për bizneset me kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a/ bëhet nga kjo shoqëri.

Për bizneset pa kontratë me Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Pogradec sh.a, vjelja bëhet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të, ndarë në dy këste:

- Kësti i parë deri në 30 qershor të vitit fiskal
- Kësti i dytë deri në 31 tetor të vitit fiskal

1.6 Taksa e ndikimit në infrastrukturë :

Kjo taksë zbatohet për zhvillimet që kërkojnë pajisjen me lejë ndërtimi dhe llogaritet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për m² të investimit të ri, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe të gjitha tarifat e tjera, paguhet para dorëzimit të dokumentit të lejës së ndërtimit.

Kategorië dhe nënkategorië Objekte të reja/Shëresa	Njësia	Qyteti Pogradec Nj.Adm. Baçimas, Udenisht	Çfarëvë	Nj.A të tjera
III.1.1.Banesa Individuale	Në % sipas vlerës së preventivit	3	3	2
III.1.2.Banesa Kolektive dhe Kompleks banimi	Në % sipas vlerës së preventivit	5	4	3
III.1.3.Ndërtesa Shërbimi dhe Hotelerie, Shqetore e Argëtimi	Në % sipas vlerës së preventivit	4	3	3
III.1.4.Ndërtesa Industriale	Në % sipas vlerës së preventivit	3	3	2
III.1.5. Struktura Bujqësore/Blegtorale	Në % sipas vlerës së preventivit	3	3	2
III.1.6 Ndërtesa Shëndetësore, Arsimore, e Sportive	Në % sipas vlerës së preventivit	2	2	2
III.1.7 Objekte të tjera (mur rrethues, s hkalje etj.)	Në % sipas vlerës së preventivit	2	2	2
III.1.8.Për objekte që janë në proces le galizimi	Në % sipas vlerës së preventivit	0.5	0.5	0.5
III.1.8/1.Për objekte të dyta që janë në proces legalizimi	Në % sipas vlerës së preventivit	2	2	2
III.1.9.Për objekte infnrastruktore (Por jo më pak se kosto e rehabilitimit)	Në % sipas vlerës së preventivit	0.1	0.1	0.1



Detyrimi për llogaritjen dhe vjeljen e kësaj tarife i takon punonjësve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe pagesa do të kryhet nëpërmjet Postës Shqiptare ose Bankave të Nivelit të II-të.

Përfshihen nga pagesa e kësaj takse:

1. Investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një me tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

2. Investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuara si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

Për këto kategori të investimeve, në momentin e aplikimit nga investitori për marrje leje ndërtimi, nuk i llogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë. Institucioni lëshues i lejes së ndërtimit, pavarësisht lëshimit të kësaj leje, nuk duhet të lëshojë lejen e shfrytëzimit të objektit, pa u vërtetuar më parë nga investitori se objekti i ndërtuar është i çertifikuar nga Ministria përgjegjëse e turizmit sipas një nga kategoritë përkatëse të përjashtimit. Me përfundimin e objektit, investitori është i detyruar të kërkojë dhe të pajiset me çertifikimin përkatës, përpara marrjes së lejes së shfrytëzimit. Në rast të mosçertifikimit të objektit si kategori e rasteve të përjashtuara nga taksa, atëherë përpara dhënies së lejes së shfrytëzimit, llogaritet shuma e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe investitori është i detyruar ta paguajë atë menjëherë. Në rast të mospagesës së kësaj takse, zbatohen procedurat e parashikuara për mbledhjen me forcë të detyrimit.

3. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pikë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



KAPITULLI II

TARIFA VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit, baza e taksueshmërisë, kategorizimet dhe nënkategorizimet, sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Në ndarjen sipas Zonave ne kemi përcaktuar dy zona (bashkangjitur harta e qytetit):

- ✓ Zona A
- ✓ Zona B



Në **Zonën A** (skica bashkangjitur) përfshihen bizneset që zhvillojnë aktivitetet në rrugët kryesore të qytetit:

- Rruga "Kajo Karafili"
- Rruga "Reshit Çollaku" 1 dhe 2
- Rruga "10 Dëshmorët e Pojskës"
- Rruga "Islam Dani"
- Rruga "Rinia"
- Rruga "Naim Frashëri"
- Rruga "Gani Butka"
- Rruga e "Korçës"
- Rruga "Abdyl Frashëri"
- Rruga "Industriale"
- Rruga "Fan Noli"

Në **Zonën B**, e gjithë pjesa tjetër e Qytetit.

Përfshirje dhe lehtësime:

- Përfshihen nga tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit OJF-të.
- Përfshihen nga tarifat bizneset që zhvillojnë aktivitetet për punime artizanale.
- Tarifat vendore reduktohen në masën 25 % në vitin e parë të aktivitetit për bizneset e reja, të cilat punësojnë mbi 25 punonjës.
- Tarifat vendore reduktohen në masën 25 % në vitin e parë të aktivitetit për bizneset e reja që hapen nga individë deri në moshën 25 vjeçare.
- Tarifat vendore reduktohen në masën 20% për vitin e parë për bizneset e reja, të cilat administrohen nga gratë,
- Përfshihen nga tarifat vendore gratë kryefamiljare, të cilat nuk janë në marrëdhënie pune.
- Përfshihen nga tarifat vendore pensionistet vetëm, pa bashkëshortin/ bashkëshorten.
- Përfshihen nga tarifat vendore fshatrat e Njësisë Administrative, në të cilat është e pamundur të ofrohet shërbimi i pastrimit për shkak të infrastrukturës.
- Përfshihen nga tarifat vendore qytetarët, të cilët kanë gjendjen civile në Bashkinë Pogradec, por nuk kanë shtëpi banimi në pronësi të tyre dhe nuk janë rezidentë në Pogradec.
- Pensionistët e vetmuar, të regjistruar në Gjendjen Civile dhe rezidentë në Bashkinë Pogradec, paguajnë 70% të tarifave.
- Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike paguajnë 70% të tarifave.

II.1 TARIFA E PASTRIMIT

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë, ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Pogradec, në çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin.



II.1.1 Për Familjet:

Kategoritë	Njësia	Pogradee	Buçimas Udënisht	Çërravë	Proptisht, Velçan, Dardhas, Trebinjë
Për çdo banesë në Bashkinë Pogradee	lekë/vit	4 000	4 000	2 800	1 100
Për çdo shtëpi banimi me oborr në territorin e Bashkisë Pogradee oborri i të cilës është më pak 100 m ²	lekë/vit	4 400	4 400	3 000	1 100
Për çdo shtëpi banimi me oborr në territorin e Bashkisë Pogradee oborri i të cilës është më shumë se 100 m ²	lekë/vit	4 800	4 800	3 300	1 200

II.1.2 Tarifa e pastrimit për Bizneset:

Tarifa e pastrimit për biznesin përcaktohet sipas kategorive të mëposhtme:

A. Tarifë pastrimi për biznesin me xhiro nga 0-2 milion lekë:

Kategoritë e Biznesit	Njësia	Zona A, Tushemisht	Zona B, Pogradee	Buçimas, Udënisht	Çërravë	Proptisht, Velçan, Dardhas, Trebinjë
Ushqimore (shumicë)	lekë/vit	16 560	16 560	15 840	12 240	1 296
Ushqimore (pakicë)	lekë/vit	14 400	10 800	10 080	7 200	1 296
